VENDIM
Nr. 90, datë 24.2.1997

PËR NJË SHTESË NË FONDET E KUSHTËZUARA PËR BUXHETIN E SHTETIT PËR PERIUDHËN JANAR-MARS 1997

Me propozimin e Ministrisë së Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zërin "fonde të kushtëzuara" për Sekretariatin Shtetëror për Pushtetin Lokal shtohen 70 milionë lekë. Ngarkohet Sekretariati Shtetëror për Pushtetin Lokal për detajimin e këtij fondi për çdo organ të pushtetit lokal.

2. Në zërin "fonde të kushtëzuara" Drejtorisë së Doganave i shtohen 10 milionë lekë. Ky fond do të përdoret për investimet në proces të kësaj drejtorie.

3. Në zërin "fonde të kushtëzuara" Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave të Shtetit i shtohen 4 milionë lekë. Ky fond do të përdoret për investimet në proces të kësaj drejtorie.

4. Fondi prej 84 milionë lekësh përballohet nga zëri kontingjencë, parashikuar në buxhetin e 3-mujorit të parë të vitit 1997.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi